



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1879/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbaremore të kreditorit N.T.SH A..., me seli në Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson zyra ligjore “...” L.L.C, kundër debitorit Komuna e Gjilanit me seli në Gjilan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.217/2022 të datës 11.05.2022 të Përmbaremit Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 18.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Gjilanit, ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.217/2022 i datës 11.05.2022, i lejuar nga Përmbaremit Privat Sefer Sh. Arifi, për pjesën e kamatës në lartësi prej 8 % për shumën e borxhit kryesor në vlerën prej 1,824.00 € (njëmijë e tetëqind e njëzet e katër euro).
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbaremit P.nr.217/2022 të datës 11.05.2022, i lejuar nga Përmbaremit Privat Sefer Sh. Arifi, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 1,824.00 € (njëmijë e tetëqind e njëzet e katër euro).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbaremore e kreditorit N.T.SH A..., ndaj debitorit Komuna e Gjilanit, sipas Urdhrit Përmbaremit P.nr.217/2022 të datës 11.05.2022 të Përmbaremit Privat Sefer Sh. Arifi, për pjesën e kamatës në lartësi prej 8 % për shumën e borxhit kryesor në vlerën prej 1,824.00 € (njëmijë e tetëqind e njëzet e katër euro).

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.238/17 të datës 17.10.2019, ka nxjerr urdhrin P.nr.217/2022 me datën 11.05.2022, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbarimit, ndaj debitorit Komuna e Gjilanit me seli në Gjilan, duke e detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimit të paguaj borxhin në shumën prej 1,824.00 €, me kamatë vonës prej 8%, duke filluar nga data kur detyrimi i pa paguar është bërë i arritshëm me, si dhe shumën prej 156.00 € për përpilimin e propozimit për përmbarim me të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi e të cilat duhet të realizohen përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare të debitorit me bartjen e tyre në llogarinë e veçante të përmbaruesit privat.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se urdhri për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 36 dhe 37 të LPP-së, duke shtuar se me propozimin për përmbarim të lejuar nga përmbaruesi privat është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimit të papaguar të paguaj borxhin në shumën prej 1,824.00 € me kamatëvonese prej 8 % në vit, duke filluar nga data kur detyrimi i papaguar është bërë i arritshëm për pagesë, duke shtuar se me propozimin për përmbarim është lejuar edhe pjesa e kamatës sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, ndërsa me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike V.Ek.nr.238/17 debitori është detyruar që në emër të kompensimit të shpenzimeve operative të paguaj shumën prej 1,100.00 € me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 11.05.2017 deri në pagesën përfundimtare, ndërsa në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore është detyruar debitori që kreditorit të ia paguaj shumën prej 724 € pa kamatë ligjore, duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitori dhe të shfuqizohet urdhri për përmbarim P.nr.217/2022 i datës 11.05.2022.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se në rastin konkret dokumenti përmbarues është i formës së prerë dhe i përmbarueshëm dhe se prapësimi nuk është i bazuar në dispozitat e nenit 71 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas dokumentit përmbare (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.238/17 të datës 17.10.2019, në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht kërkesëpapia e paditësit N.T.SH. A... dhe është detyruar e paditura Komuna e Gjilanit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve operative t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1,100.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë me datë 11.05.2017 deri në pagesën përfundimtare në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpapia e paditësit që në emër të TVSH-së, e paditura t'ia paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 2,655.78 €, si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 12,288.90 €, ndërsa në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumën në lartësi prej 724.00 €.

Gjykata gjen se dokumenti përmbare – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.238/17 i datës 17.10.2019 i formës së prerë nga data 14.06.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 20.07.2021 është i dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbare duhet ta përmbajë kërkesën për përmbare në të cilën do të tregohet dokumenti përmbare origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbaremi, kërkuesi i përmbaremit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbaremi, objekti i përmbaremit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbaremit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbare e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbare (titulus executionis) dhe dokumentit*

të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbarese siç janë: “vendimi përmbare i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbare;”, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se “ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, vlerëson se urdhri për përbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbare dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, dhe i njëjti është i pambarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi, duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata pas shqyrtimit të urdhrin Përbarimor P.nr.217/22 të datës 11.05.2022, të Përmbaresit Privat Sefer Sh. Arifi, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe atë sa i përket pjesës së kamatës në lartësi prej 8%, pasi që urdhri përbarimor i lejuar nuk ka qenë në përputhje me dokumentin përbarimor për pjesën e kamatës në lartësi prej 8 % për shumën në vlerën e përgjithshme prej 1,824.00 €.

Sipas dokumentit përbarimor mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri për përbarim, debitori është detyruar që të ia paguaj kreditorit kamatëvonesën vetëm për shumën në lartësi prej 1,100.00 €, por jo edhe për pjesën e shpenzimeve procedurale në shumën prej 724.00 €, dhe

meqenëse në rastin konkret kreditori me propozimin për përmbarim të lejuar me urdhrin e përmbaruesit privat ka kërkuar kamatëvonesën edhe për pjesën e shpenzimeve procedurale në shumën prej 724.00 €, duke e përfshirë kamatëvonesën për shumën e përgjithshme të detyrimit në vlerë prej 1,824.00 €, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1879/22 datë 18.11.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve

nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.